



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:057501

Datë: 21.10.2019

Numri i dokumentit: 00589760

Numri i lëndës: 2018:057501

Datë: 15.02.2019

Numri i dokumentit: 00227039

P.nr.203/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bash. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A E nga fsh. S Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.568-7/16, të datës 26.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të Prokurorit të Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit, mbrojtësit avokate N H nga Suhareka dhe të dëmtuarës KEDS të përfaqësuar nga Y M, me datë 15.10.2019 mori publikisht shpalli dhe me date 18.10.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A E, nga babai R dhe nëna Z E e lindur Piraj, i lindur me 27.03.1975, në fshatin S1 Komuna S, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë. me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pavërtetuar e deri me dt.04.12.2015, në biznesin e tij Auto Shkolla “K P” – Restaurant Auto servis, përfiton nga shërbimi që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë të drejtpërdrejtë jashtë njuhësorit elektrik, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

-këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind) euro**, të cilin është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në të kundërtën, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burgim, respektivisht 10 (dhjetë) ditë burgim, dhe

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton **dënimin me burgim prej 4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara KEDS D P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.568-7/16 të datës 26.04.2016, kundër të akuzuarit A E, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së.

Në rigjykim, ku palët u pajtuan që të bëhet leximi dhe administrimi i provave, prokurori i shtetit Besim Susuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.II.nr.568-7/16 të datës 26.04.2016, kundër të akuzuarit A E, nga fshati D Komuna S për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke theksuar se gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë u vërtetua në tërësi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Mbrojtësja e të akuzuarit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëgjimit të dëshmitarëve, administrimit të provave material si dhe dëgjimit të akuzuarit, me asnjë fakt nuk është vërtetuar se dëshmitarët – punëtorët e KEDS-it kanë hyrë në vendim ku ka qenë e vendosur ora dhe se të njëjtit e kanë pare për së afërmi sa ora kanë qenë të vendosura, sa kablllo dhe si kanë qenë të lidhura këto kablllo me orë, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që ta refuzon aktakuzën si të pabazuar në fakte dhe prova material.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se prej datës së pavërtetuar e deri me dt.04.12.2015, i akuzuari pikërisht në biznesin e tij Auto Shkolla “K P” – Restaurant Auto servis, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me një lidhje direkte jashtë njehësorit, ashtu që energjia e shpenzuar nuk regjistrohet, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në P i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga shkresave të lëndës dhe ate procesverbali me nr.1180161 dt.04.12.2015 dhe vazhdimi i procesverbalit 11..... dt.04.12.2015 i hartuar nga KEDS, fatura DPZ 15 HP 1..... dt.07.12.2015, dhe fotodokumentacioni në shkresa të lëndës si dhe dëgjimi i dëshmitarëve – punëtorëve t, N. Zh. dhe B. G..

Nga procesverbali me nr.1180161 dhe vazhdimi i procesverbalit me nr.1180162 të dt.04.12.2015 u vërtetua se i akuzuari ka bërë degëzim – pickim nga kablli kryesor i furnizimit, ka kyçur kabllin direkt jashtë pikes matëse, e ka prurë në ndërprerës kryesor 1-0-2 dhe përmes ndërprerësit është shpërndarë energjia në komplet objektin duke i furnizuar pajisjet e përshkruara si më afër në procesverbalet e cekura më lart. Kjo provë material është vërtetuar edhe me anë të fotodokumentacionit nga ku shihet se është bërë degëzimi – pickimi nga kablli kryesor i furnizimit.

Dëshmitari A G – ekspert për kontrollimin dhe monitorimin e humbjeve komerciale pranë KEDS-it P, ka deklaruar se është nënshkruar i procesverbalit me nr.11..... dhe 11..... dt.04.12.2015 dhe se mbetet në ëtërsi pranë konstatimit se i akuzuari ka bërë degëzimin – pickimin nga kablli kryesor i furnizimit, ka kyçur kabllën direkt jashtë pikes matëse duke bërë lidhje të dyfishtë e këtë kabëll ora nuk e mat, duke theksuar më tej se në këtë lidhje e kemi testuar në vend të ngjarjes dhe kemi konstatuar se lidhja komplet ka kaluar në kabllën që nuk është tu e mat njëhësorin, shpenzimet janë bërë jashtë orës. Kanë qenë të kyçne tri faza pa matje jashtë njëhësorit.

Dëshmitari A Zh – ekspert për kontrollimin dhe monitorimin e humbjeve komerciale pranë KEDS-it në P, ka deklaruar se qëndroj në tërësi pranë konstatimit si në procesverbalin e dt.04.12.2015, dhe ka theksuar se i akuzuari nga kablli i furnizimit ka ndërhyrë me një kabëll tjetër në formë të pickimit që shihet edhe nga fotografit.

Ndërkaq dëshmitari B G - ekspert për kontrollimin dhe monitorimin e humbjeve komerciale pranë KEDS-it në P, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë konstatimit si në procesverbalin e dt.04.12.2015 dhe ka theksuar se punëtorët që kanë qenë prezent në lokalin e të akuzuarit kanë refuzuar që të e nënshkruajnë procesverbalin.

I akuzuari ka deklaruar se ditën kritike nuk kam qenë prezent në lokal, punëtorët e KEDS-it kanë ardhë në orët e vona 8-9 ora të cilët kanë dyshuar se po keqpërdoret rryma dhe nuk kanë pas mundësi që të kenë qasje në objekt – të hynë brenda dhe aty kanë qenë dy njëhësor, njëra në pompë tjetra në servis. Më tej ka theksuar se ai është pronar i pompës dhe servisit duke shtuar se punëtorët e tij e kanë njoftuar për kontrollën e KEDS-it, të nesërmën kanë ardh një ekip e KEDS-it nga Prizreni për të verifikuar dhe kanë konstatuar se në lokalin tim ka keqpërdorime. Në fund ka deklaruar se vazhdimisht ka paguar faturat e shpenzimit të energjisë 60, 80 e 120 euro në muaj.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nga të cilat në mënyrë bindëse u konstatua se i akuzuari ka përfituar nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në biznesin e tij Auto Shkolla “K P” – Restaurant Auto servis, duke i shkaktuar dëm material, të dëmtuarës KEDS Distrikti në P. Ndërsa deklaratën e të akuzuarit kur nuk e pranoi fajësinë e vlerësoi si qëllim shmangie nga përgjegjësia penale, ndërsa deklaratat e dëshmitarëve i vlerësoi si të drejta dhe reale të cilave ua falë besimin, andaj mbi këtë bazë dhe duke u bazuar në secilën prove veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjykata ka ardhur në përfundim, se faktet që përmban aktakuza janë provuar në tërësi si të bazuara, andaj në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjer më tani i pa dënuar, çka nënkupton se nuk ka rënë ndesh me rregullat pozitive, gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimime, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i duhur ndëshkimit, që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla apo të ngjashme.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
P.nr.895/16 të dt. 18.10.2019

Bashk.Profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Qemal Suka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.